

Në bazë të nenit 22, paragrafi 8 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/2014, 199/2014, 27/2016, 35/2018 dhe 198/2018 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 143/2019 dhe 14/2020), ndërsa në lidhje me nenin 22, paragrafi 1, pika 1 dhe nenin 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 62/2005, 106/2008...120/2018 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 267/2020, 151/2021 dhe 288/2021), Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

për punësim të një realizuesi për kohë të caktuar edhe atë:

1. Bashkëpunëtor më i ri për përpilim dhe shqyrtim të dokumentacionit, departamenti për përmirësim të konkurrencës në bujqësi, sektori për miratimin e projekteve – 1 (një) realizues.

Krahas kushteve të përgjithshme për punësim të cekur në këtë shpallje, kandidatët për këtë vend pune duhet të plotësojnë edhe kushtet e veçanta në vijim:

- Niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës kualifikuese të Maqedonisë dhe së paku 180 kredi të arritura sipas SETK ose shkallën VII/1 të mbaruar nga fusha e **makinerisë, pylltarisë dhe hortikulturës ose shkencat politike,**

- me ose pa përvojë pune në profesion dhe
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe njohje aktive të një prej tri gjuhëve më të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht).

Neto paga mujore: përafërsisht 22.569,00 denarë.

Secili nga kandidatët për vendet e cekura të punës, krahas kushteve të theksuara, duhet të plotësojë edhe kushtet e përgjithshme për punësim të cekur në nenin 31 të Ligjit për nëpunës administrativ ("Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë" numër 27/2014, 199/2014, 48/2015, 154/2015, 5/2016, 142/2016 dhe 11/2018 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 275/2019, 14/2020, 215/2021 dhe 99/2022) edhe atë:

- të jetë shtetas i R. Maqedonisë së Veriut
- në mënyrë aktive ta përdorë gjuhën maqedonase
- të jetë i moshës së rritur

- të ketë gjendje të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës

- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos ketë të shquar dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Java e punës zgjat 5 ditë pune, nga e hëna deri të premten. Orari i plotë i punës është 40 orë në javë, ndërsa gjatë ditës zgjat 8 orë edhe atë me fillim prej orës 07:30 dhe 08:30 dhe përfundim mes orës 15:30 dhe 16:30.

Vendi i shpallura i punës është për punësim për kohë të caktuar me kohëzgjatje deri 31.12.2022.

Me kandidatët e përzgjedhur do të lidhet marrëveshje për punësim për kohë të caktuar.

Kushtet e cekura në shpalljen kandidatët duhet të plotësojnë në momentin e paraqitjes.

Dokumentet e duhura për aplikim:

- biografi të shkurtë në gjuhën maqedonase (CV) **ku në faqen e parë do ta theksoni për cilin vend të punës apo vende të punës aplikoni,**

- certifikatë për arsim përkatës të mbaruar (kopje) dhe

- certifikatë të shtetësisë (kopje).

Dokumentet është e nevojshme të dërgohen në zarf të mbyllur në të cilin do të shënohet "shpallje për punësim" në adresën në vijim:

Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural

Bul. 3-ta Makedonska brigade numër 20 (ndërtesa e Makedonija tabak, blloku C)

1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

ose të dërgohen personalisht në sportelin e Agjencisë.

Ju lutemi ti parashtroni vetëm dokumentet e kërkuara dhe ashtu siç është cekur – në kopje.

Afati për parashtrimin e dokumenteve është tre ditë pune nga dita e publikimit të kësaj shpallje.

Dokumentacioni i vonuar dhe i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.

Zgjedhja e personave për marrëdhënie të punës për kohë të caktuar në Agjencinë për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural do të bëhet në afat prej 45 ditëve nga dita e skadimit të afatit për paraqitje.

Inkurajohen të gjithë kandidatët që konsiderojnë që janë të aftë, të motivuar për punë ekipore dhe i plotësojnë kushtet, të aplikojnë në këtë shpallje.

Vërejtje: Të gjitha aplikimet do të shqyrtohen me vëmendje nga ana e Komisionit të Agjencisë për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural. Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet e duhura për vendet e punës që kanë aplikuar dhe kanë dokumentacion të rregullt do të kontaktohen.

Komunikimi me aplikuesit do të zhvillohet vetëm përmes e-mail, për atë shkak është e nevojshme në që CV e juaj ta shënoni e-mail adresën të cilën e shfrytëzoni rregullisht.

Më shumë informacione për veprimtarinë e Agjencisë për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural mund të gjenden në www.iparda.gov.mk

Personi për kontakt:

Angelina Jovanovska

e-mail: angelina.jovanovska@ipardpa.gov.mk

Tel. +389 2 2445 851

 **ЦЕНТРАЛЕН РЕГИСТАР**
НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

Бул. К. Ј. Питу бр. 1, 1000 Скопје
тел. +389 2 3288 100

www.crm.com.mk

Për qëllime të Projektit - Përmirësimi i sistemit të shpërndarjes, sistemit të certifikatave elektronike dhe sistemit të pagesave elektronike (Vendim nr. 03-103/6 e datës 02.02.2022) Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut publikon

THIRRJE PUBLIKE

për mbledhjen e ofertave për prokurimin e DORËZUESIT TË DOKUMENTEVE NË ADRESË - për kryerjen e shërbimeve postare të realizuara nëpërmjet tregtisë elektronike, gjegjësisht shërbime korrieri për persona juridikë dhe fizikë

1) E drejta për të marrë pjesë

Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjitha subjektet juridike të themeluara në Republikën e Maqedonisë së Veriut të cilët i posedojnë të gjitha licencat dhe autorizimet e nevojshme dhe të duhura për transportin e brendshëm të dërgesave.

2) Kriteret e përzgjedhjes

1. Statusi aktual nga Regjistri Qendror i RMV jo më i vjetër se 6 (gjashtë) muaj;
2. Gjatë tre viteve të fundit ka kryer shërbim shumë profesional që u ofron përdoruesve të tij dërgimin më të shpejtë, cilësor dhe më të besueshëm të dërgesave postare në vend, në përputhje me rregulloret dhe afatet e përcaktuara të dërgimit;
3. Ofertuesi është i detyruar të paraqesë një listë referencë të kompanive me të cilat ka bashkëpunuar, pra ka punuar me të paktën 5 kompani në vazhdimësi për të paktën 1 vit, në 3 vitet e fundit;
4. Ofertuesi duhet të ketë një Sistem shumë të sofistikuar për njoftimin dhe përcjelljen e dërgesave përmes të cilit përdoruesit do të kenë një pasqyrë të plotë për statusin e secilës dërgesë, pra të kenë softuer modern për regjistrimin e dërgesave dhe mundësinë e gjurmimit të tyre;
5. Ofertuesit i kërkohet të punojnë në përputhje me standardet ndërkombëtare për shërbim cilësor dhe të punojnë me një ekip shumë të trajnuar dhe profesional.
6. Ofertuesi duhet të ketë burimet e nevojshme për të mbuluar qytetin e Shkupit dhe të gjitha zonat e banuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut për dorëzimin e dërgesës brenda 24 orëve nga porosia në të gjithë territorin e vendit, në ditë pune;
7. Për dorëzimin, përdoruesi i fundit paguan tarifë drejtpërdrejtë të furnizuesit për shërbimin - dërgimin në adresë, pavarësisht nga çmimi i konfirmimit për të cilin është bërë pagesa elektronike në një nga llogaritë e Regjistrimit Qendror. Përdoruesi përfundimtar do të informohet për kompensimin e furnizuesit përmes sistemit kur porosit dokumentin.
8. Përparësi do të ketë ofertuesi që është një kompani e ndërgjegjshme për mjedisin, domethënë kujdeset për mjedisin dhe zbaton standardet e vlerave ekologjike gjatë kryerjes së veprimtarisë së saj.

3) Përzgjedhja e ofertuesit

Për ofertuesin më të favorshëm, Regjistri Qendror do të përzgjedhë ofertuesin që plotëson kriteret e përcaktuara dhe që do të ofrojë çmimin më të ulët dhe të barabartë për dërgimin e të gjitha dërgesave me dokumente në të gjithë vendin.

4) Dorëzimi i ofertave

Afati i fundit për dorëzimin e ofertës 27.10.2022, ora 13:00.

Ofertat duhet të dorëzohen në Regjistrin Qendror të RMV - në Arkiv, me seli në Bul. Kuzman Josifovski - Pitu nr. 1, Shkup ose në mënyrë elektronike në adresën elektronike të mëposhtme: marketing@crm.org.mk, me shënimin DORËZUESIT TË DOKUMENTEVE NË ADRESË.

Ofertuesi i përzgjedhur do të njoftohet në mënyrë elektronike se oferta e tij është pranuar, maksimumi 3 ditë pune nga marrja e vendimit për përzgjedhjen e ofertës më të favorshme. Në të njëjtën kohë, të gjithë ofertuesit e tjerë do të njoftohen për rezultatet e thirrjes, përkatësisht për vendimin se kush është ofertuesi më i favorshëm.

Ofertuesit e interesuar mund të marrin informacion në adresën e mëposhtme:

marketing@crm.org.mk ose tel. 078/490-940 jo më vonë se 21.10.2022 dhe të vizitojnë ueb faqen www.crm.com.mk ku mund të shkarkohet Aplikacioni për Pjesëmarrje.

Regjistri qendror i
Republika e Maqedonisë së Veriut

Shpallje publike e RDM

për mbajtjen e Kongresit të Pestë të RDM më 27.11.2022

RDM e publikon këtë shpallje publike bazuar në nenin 31 paragrafi 3 të Statutit të RDM-së dhe vendimit të Këshillit Qendror të RDM-së të datës 16.10.2022, sipas të cilit Kongresi i Pestë i RDM-së duhet të mbahet më 27.11.2022.

RDM fton anëtarët e RDM-së që të raportojnë në organizatat komunale në vendbanimet e tyre, për të shprehur interesimin për të kandiduar për anëtarësim në organet dhe trupat e RDM-së që do të zgjidhen në Kongres.

Nga kandidatët dhe kandidatet e interesuar pritet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- të ndajnë vlerat e gjelbra;
- të pranojnë përcaktimet programore të RDM-së;
- të respektojnë dispozitat e Statutit të RDM-së dhe Kodit të Gjelbër të Sjelljes të RDM-së;
- të jenë persona me integritet, të respektuar në mjedisin e tyre;
- të ketë një kontribut aktiv në zhvillimin e idesë së gjelbër përmes RDM-së;
- të posedojnë profesionalizëm dhe njohuri të proceseve politike.

Gjatë përzgjedhjes përfundimtare do të merret parasysh balanca gjinore dhe përfaqësimi i grupmohave të ndryshme, me theks tek të rinjtë.

Kandidatët e interesuar mund të aplikojnë në organizatat e tyre komunale jo më vonë se 16.11.2022.

Kontakti në numrat e telefonit dhe e-mailin për informacion më të detajuar:

076311601, dommakedonija@yahoo.com

Ripërtëritja Demokratike e Maqedonisë – RDM